**(c)** Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**(d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

**(e)** Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ------------- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

**(f)** Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ------------- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|---|
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë __________________** | |

**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data**: ____________________________________

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
____________________________________

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _________________________________________________

**Monedha**: ____________

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për sherbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si sherbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| ***1*** | ***2*** | ***3*** | ***4*** | ***6*** | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Artikulli** | **Përshkrimi i shërbimit** | **Sasia** | **çmimi për njësi** | **Çmimi total për sherbim (*3* x *4X*)** | |
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| 4 | | | | | |
| | **Çmimi total (Mallrat)** | | | | _____________ |

| | |
|---|---|
| **Çmimi Neto pa TVSH** | |
| **TVSH (%)** | |
| **Çmimi total me TVSH:** | |
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |

| | |
|---|---|
| **Vula** | |
| **Datë ________________** | |

**Shenim: Sipas Tors pika 6** “Zërat e projektit” të parshikuar në Termat e References.

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

**SPECIFIKIME TEKNIKE**

**<u>Objekti i Shërbimit</u>**

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e sistemeve Eterna ne tëresi perfshirë çdo komponent të tyre, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në zyrat postare në të cilat janë instaluar këto sisteme.

Komponentet kryesore të këtyre sistemeve janë:
Eterna Financiare 2.0.7.8 (version i fundit publikuar me 26 Janar 2024)
Eterna Postare 1.3.4.2 (versioni i fundit i publikuar Nëntor 2023)
Buzines Hub
Eterna Gateway 2.0.7.8 (version i fundit publikuar me 26 Janar 2024))
Eterna Finance-Kontabilitet, Burime Njerezore, Magazina 2.0.7.8 (version i fundit publikuar me 26 Janar 2024)
Posta Retail Outlet ( eCommerce)
E-Posta
Business Inteligence, Datawarehouse dhe Log Management

Ky shërbim duhet të mirëmbajë të gjitha funksionalitet ekzistuese të versioneve të mesipërme .

Lista e moduleve kryesore të sistemit Eterna dhe funksionalitet kryesore teEterna Financiare, Eterna Postare, Eterna Gateway dhe Eterna Finance-Kontabilitet, Burime Njerezore, Posta Retail Outlet, Buzines Hub jepet ne vijim

**<u>Lista e Moduleve të Eternës Postare</u>**

- Pranimi i objekteve

a. Lista e objekteve të pranuara
b. Prano objekt postar
c. Lista e objekteve të pranuara nga jashtë
d. Prano objekt të ardhur nga jashtë
e. Lista e objekteve të pranuara në tranzit
f. Prano objekt postar në tranzit
g. Lista e objekteve të pranuara nga Kosova
h. Prano objekt nga Kosova
i. Ripostimi i objekteve postare
j. Ripostimi i aprovimit/refuzimit të fshirjeve të objekteve postare
k. Pranimi i objekteve zyrtare
l. Kërkimi i objekteve postare
m. Listë objektesh të fshira
n. Rieksporto të dhëna IPS

- Numrat e Dërgesave Postare
  a. Nr. Dërgese e re
  b. Lista e Nr. Dërgesave

- Përpunimi i Thasëve Postarë
  a. Krijimi i LD/ Thasëve
  b. Hapja e Thesit Postar
  c. Hap thes IPS

- Transporti i Thasëve
  a. Dërgo Thes
  b. Merr Thes në dorëzim
  c. Raporti përmbledhës sipas linjës
  d. Numrat e dërgesave për transport
  e. Lista Automjeteve
  f. Shtimi Automjeteve
  g. Prano linjë transporti

- Shpërndarja
  a. Regj. i shpërndarësit P8
  b. Listë objektesh në pritje për dorëzim
  c. Paradorëzim i objektit
  d. Regj. i dorëzimit në adresë
  e. Printo regjistër pranimi
  f. Dorëzimi objekteve
  g. Kthim objektesh në origjinë
  h. Tentativë e pasukseshme shpërndarje
  i. Hapje thesi në dorëzim
  j. Hapje thesi dhe dorëzim në adresë
  k. Në pritje për dorëzim në sportel.

- Ngjarjet Manuale
  a. Dorëzim objekti brenda sektorit
  b. Pranim objekti brenda sektorit
  c. Ngjarje manuale specifike
  d. Pranim objekti ndërmjet sektorëve
  e. Dorëzim objekti ndërmjet sektorëve

f. Dogana
    I. Futja e objekteve në doganë
    II. Pritje objekti në doganë
    III. Dalje objekti nga dogana
    IV. Lista e kontrollove doganore
    V. Modifiko të dhënat doganore
    VI. Printo manifest.
    VII. Modifiko të dhënat e manifestit

- Konfigurime Sistemi
    a. Zyrat Postare
    b. Konfigurimi i objektit Postar
    c. Konfigurimi i tarifave të objektit Postar
    d. Detajet e itinerareve
    e. Skedulimet automatike

- Konfigurimet Sekondare
    a. Konfigurimi i zonave
    b. Itineraret
    c. Tipet e transportit
    d. Shtetet
    e. Objektet Postare
        I. Destinacionet
        II. Klasat e objekteve postare
        III. Mënyrat e dorëzimit
        IV. Mënyrat e transportit
        V. Shërbimet e veçanta
    f. Konfigurimi i kodeve
    g. Ngjarjet në sistem
    h. Qytetet
    i. Institucionet
    j. Planet tarifore
    k. Arsye bllokimi në doganë
    l. Arsye mosdorëzimi
    m. Peshoret

- Aksesi në sistem
    a. Lista e përdoruesve
    b. Të drejtat e roleve
    c. Shoferët
    d. Postierët

- Konfigurimi i kompjuterave
    a. Lista e kompjuterave
    b. Kompjuteri lokal

- Lidhje me Eterna Postare
    a. Lidhja e përdoruesve me arkat

- Gjurmimi
    a. Gjurmimi i objekteve
    b. Gjurmimi i thasëve

- Ndyshimi i fjalëkalimit

- IPS Import Export
    a. Export
    b. Import

**<u>Lista e Moduleve të Eternës Financiare</u>**

- Informacion klienti
    a. Individë
    b. Subjekte
    c. Mbajtës llogarish
    d. Administrim llogarish
    e. Verifikim IBAN

- Transferim fondesh
    a. Transferim fondesh cash to cash
    b. Pagesa transferte cash to cash
- Transferimi llogari-llogari
    a. Lista e skedulimeve
    b. Shto skedulim

- Letra me vlerë
    a. Shto ankand
    b. Lista e ankandeve
    c. Shto kërkesë
    d. Lista e kërkesave
    e. Llogarit emetim
    f. Emeto ankandin
    g. Shto transaksion në treg sekondar
    h. Lista e transaksioneve
    i. Maturimi i ankandeve
    j. Lista e klientëve

- Shërbime
    a. Energji elektrike (OSHEE)
    b. Pagesat e ujësjellësit
    c. Pagesat e doganës
    d. Pagesat e taksave të bashkise
    e. Gjobat e mjeteve
    f. Akomodimi i studentëve
    g. Legalizimi i dokumentave
    h. Dëshmi penaliteti
    i. Tarifa Shkollore
    j. Tarifa Kopshte
    k. Tarife çerdhe
    l. Pagesat e tatimeve
    m. Hipoteka
    n. Digicom
    o. Rimbushjet elektronike ( One mobile)
    p. Ambasada Italiane
    q. Iute Credit aplikime për kredi
    r. Iute Credit arketime
    s. Tvsh Kredimi i Fermereve
    t. Tvsh Pagesa e Fermereve
    u. Credins arketime ne LEKE, EUR dhe USD.

v. Pagesa të përgjitshme

- Sherbime te Tjera

  a. Pagesë bonus i të porsalindurit
  b. Pagesë transporti të nxënësit
  c. Pagesa e bursave
  d. Ndihmë për fatkeqësitë natyrore

- Ndihmat ekonomike

  a. Pagesa Papunesie
  b. Pagese te Paafte
  c. Pagese Kujdestare paaftesi
  d. Pagese te Verber
  e. Pagese Kujdestaret e Verberise
  f. Pagese Invalid i plote
  g. Pagese invalide i pjesshem
  h. Pagese paraplegjike
  i. Pagese Kujdestare Paraolegjik
  k. Pagese Ndihme Ekonomike
  l. Kompensim Energji Elektrike
  m. Paketa Higjeno-Sanitare
  n. Pagesat e Komisionereve
  o. Pagesë  ndihmë ekonomike 6%
  p. Bonus strehimi për termetet
  q. Ndihmë financiare nga WVA
  r. Grante termeti
  s. Ndihma UNICEF
  t. Permbledhese

- Eposta
  a. Autorizo ( autorizimi i profilit te hapur ne ePosta
  b. Veprime me llogarine ( debitim ose kreditim i llogarise ewallet ne Eposta)
  c. Caktivizo perdorues ewallet
  d. Liste veprimesh
  e. Transferte bankare ( debitim i llogarise ewallet per efekt transferimi te shumes ne nje banke te nivelit te dyte)
  f. Transferte ewallet ( transferte nga nje llogari ewallet ne nje tjeter llogari ewallet)

- Administrim
  a. Hapje Dite
  b. Mbyllje Dite
  c. Skeduluesi automatik
  d. Parametrizim transaksionesh
  e. Kalendari i pushimeve
  f. Konfigurim transaksion llogari
  g. Konfigurim i orarit te tatimeve
  h. Skedar konfigurimi i transaksioneve
  i. Import pagesa
  j. Eksporto tatimet

k. Ripostim global OSHEE
l. Ripostim global gjoba mjetesh
m. Ripostim global ujesjellesish
n. Ripostim global hipoteka
o. Ripostim global taksat e bashkise Tirane
p. Ripostim global Iute Credit arketime
q. Ripostim global Iute Credit pagesa

- Siguria
  a. Administrim Siguri ( perdoruesit, rolet, aksesi ne zyrat postare)
  b. Ndryshim fjalëkalimi
  c. Administrim të formave
  d. Administrim të drejtash

**<u>Funksionalitet e Eterna Gateway</u>**

Platforma Eterna Gateway, u mundëson institucioneve financiare dhe bankare që të lidhin sistemin e tyre me sistemin Eterna të Postës Shqiptare, në mënyrë që të kryejnë nëpërmjet sporteleve të saj disa prej shërbime të tyre dhe në të njëjtën rrit gamën e shërbimeve që sportelet e Postes Shqiptare ofrojnë për klientët.

Funksionalitet e platformes jepen ne vijim.

Nderfaqe me sisteme pagesash dhe Core banking

- **Skenari i parë: Depozitë Parash**

1. Ndërlidhjen me sistemin core banking ose sistemin e pagesave të palëve të treta.
2. Klientet e bankave/institucioneve financiare të depozitojnë lek te llogaritë e tyre.
3. Walking Customer të bëjnë veprime në llogari të tjera bankare.

Rrjedha e veprimeve është si mëposhtë:

1. Klienti paraqitet pranë sporteleve të PostaShqiptare dhe kërkon të bëjë veprime në një llogari bankave / institucioneve financiare.
2. Duhet të bëhet një kërkim për klientin e paraqitur në sistemin e bankave / institucioneve financiare nëpërmjet një funksioni që lejon sa mësipër.
3. Klienti zgjedh të bëj veprime me llogaritë e tij.
   a. Në këtë rast bëhet kerkim me numrin e tij personal.
4. Klienti kërkon të depozitojë në llogarin e një tjeter personi.

   a. Me kete rast mund të kërkohet sipas numrit personal nëse është i disponueshëm, ose kombinim i emrit, mbiemrit, emrit të babait, ditëlindjes.

5. Përzgjidhet klienti i konfirmuar nga rezultati i kërkimit (nëse më shumë se një, në bazë të detajeve të kthyera i kërkon konsumatorit).
6. Një listë e llogarive të klientëve të zgjedhur i tregohet sportelistit për të zgjedhur.
7. Sportelisti zgjedh llogarinë e duhur dhe fut detajet e depozitës, duke përfshirë shumën dhe valutën, por gjithashtu detaje për klientin nëse janë të ndryshëm nga mbajtësi i llogarisë.
8. Sportelist dërgon depozitë për përpunim në sistemin bankar dhe merr konfirmim.
9. Vetëm pas konfirmimit, një faturë gjenerohet dhe dorëzohet tek klienti.
10. Në rast se nuk ka konfirmim, duhet të ketë një mesazh gabimi shpjegues (p.sh. llogaria e bllokuar), përndryshe çështja duhet të trajtohet duke komunikuar me bankën.

**Mirëmbajtja e ndërfaqes API**

Për të mbështetur skenarët e mësipërm, ndërfaqja duhet të bëjë të mundur funksionimin e komponentëve të mëposhtëm nëpërmjet API-t.

1- Kërkimi i Klientit

Kërkimi i klientit kryhet bazuar në informacionin vijues

a. Numri personal
b. Emër
c. Mbiemër
d. Emri i babait
e. Ditëlindje

Në rast se nuk jepet një numër personal, së paku 3 fusha të tjera duhet të ofrohen për kërkimin. Në rast se më shumë se një klient i plotëson kriteret e kërkimit, do të sigurohet një listë e klienteve.

Një listë paraprake e kolonave është:

a. Emër
b. Mbiemër
c. Emri i babait
d. Numri personal
e. Ditëlindje
f. Numri i konsumatorëve

2- Lista e llogarive

Kthen një listë të llogarive të klientëve me informacionin bazë. Merr si input Numrin e Klientit dhe kthimet gjithashtu:

a. Numri i llogarisë
b. Emri i llogarisë
c. IBAN

d. Monedhë
e. Status
f. Përshkrim
g. Produkti

Fusha e produktit shërben për të identifikuar nëse llogaria lidhet me një produkt të klientit si kredia ose karta krediti. Në të kundërt mund të përdoret fusha përshkrim.

3- Depozita Parash

Kryen një transaksion në sistemin e institucionit financiar, duke transferuar paratë në llogarinë e dëshiruar. Informacioni bazë është si mëposhtë:

a. Numri i llogarisë
b. Sasi
c. Monedhë
d. Data valuta
e. Data e postimit
f. Përshkrim
g. Dega / ZyraId
h. OrderingCustomerId

Rezultati përmban një status dhe nëse është i suksesshëm një ID të transaksionit.
Për veprimet e mësipërme shkruhet në një log tek moduli Eterna i cili menaxhon loget.

Të gjitha funksionet e API përfshihen si pjesë e mesazhit një RequestId, UserId dhe RequestDateTime. Rezultati përfshin gjithmonë kërkesën origjinale RequestId.

- **Skenari i dytë: Pagesë Këstesh**

1. Ndërlidhjen me sistemin core banking ose sistemin e pagesave te palëve te treta
2. Klientët e bankave/institucioneve financiare paguajnë këstet e kredisë ose kryejnë pagesa të tjera

Rrjedha e veprimeve është si mëposhtë:

1. Klienti paraqitet pranë sporteleve të postës shqiptare dhe kërkon të bëjë veprime mbi kreditë/detyrimet e pa paguara ndaj një institucioni financiar.
2. Bëhet kërkim për klientin sipas parametrave të caktuar dhe listohen kreditë për këtë klient.
3. Përzgjidhet kredia dhe për të listohen detyrimet e mbetura. Në qoftë se klienti ka numrin e referencës së kredisë atëherë kërkimi mund të bëhet direkt me të, pa pasur nevojë të kërkohen kreditë e klientit.
4. Sportelisti zgjedh këstin/detyrimin që klienti dëshiron të paguajë.
5. Sportelisti plotëson të dhënat e nevojshme për të identifikuar klientin që po bën pagesën dhe zgjedh këste të tjera për të paguar nëse klienti dëshiron të paguajë më shumë se një këst.
6. Dërgohet pagesa në institucionin financiar dhe merret konfirmimi.
7. Vetëm nëse merret konfirmim sistemi gjeneron faturë.
8. Vetëm pas konfirmimit, një faturë gjenerohet dhe dorëzohet tek klienti
9. Në rast se nuk ka konfirmim, duhet të ketë një mesazh gabimi shpjegues, përndryshe çështja duhet të trajtohet duke komunikuar me institucioni financiar.

**Mirëmbajtja e ndërfaqes API**

Për të mbështetur skenarët e mësipërm, ndërfaqja duhet të bëjë të mundur funksionimin e komponentëve të mëposhtëm nëpërmjet API-t.

1- Kërkimi i kredive të klientit

Kërkimi i kredive të klientitkryhet bazuar në informacionin e klientit dhe është si vijon

a. Numri personal
b. Emër
c. Mbiemër
d. Emri i babait
e. Ditëlindje

Në rast se nuk jepet një numër personal, së paku 3 fusha të tjera duhet të ofrohen për kërkimin. Në rast të sukseshem të kërkimit listohen kreditë e klientit. Një listë paraprake e kolonave është:

a. Numri i referencës së kredisë
b. Periudha e shlyerjes së kredisë
c. Përshkrimi

2- Lista e kësteve të kredisë

Kthen një listë të llogarive të kësteve të kredisë me informacionin bazë. Merr si input Numrin e Referencës së kredisë dhe kthimet gjithashtu:

a. Referencën e kredisë
b. Referencën unike të këstit
c. Vlerën e këstit
d. Monedhën
e. Datën e maturimit

3- Pagesa e Këstit

Kryen një transaksion në sistemin e institucionit financiar, duke kryer pagesën e këstit. Informacioni bazë është si mëposhtë:

a. Shuma
b. Data e pagesës
c. Referenca e kredisë
d. Referenca e këstit
e. Dega/Zyra Id
f. Sportelisti
g. Referenca e veprimit te posta
h. Monedha

Rezultati përmban një status dhe nëse është i suksesshëm një id të transaksionit dhe datën e proçesimit të pagesës në sistemin e institucionit financiar.

Për veprimet e mësipërme shkruhet në një log tek moduli Eterna i cili menaxhon loget

Të gjitha funksionet e API përfshihen si pjesë e mesazhit një RequestId, UserId dhe RequestDateTime. Rezultati përfshin gjithmonë kërkesën origjinale RequestId.

**Funksionalitet e Eterna Finance-kontabilitet, Burimet njerëzore, Magazina**

- **Integrimi i funksioneve te sistemit eterna me ato te finance/ kontabilitetit**

Moduli i Kontabilitetit mundëson kontabilizimin / kontrollin financiar të institucionit dhe regjistimin në librin e madh transaksionet finaciare. Ai përbëhet nga dy komponentë kryesore, skema e llogarive dhe regjistrimi i veprimeve kontabel (book-keeping)
Moduli I finances funksionon i lidhur ngushtë me sistemin eternal të postës shqiptare. Për të aritur këtë lidhje janë bërë ndryshimet dhe konfigurimet përkatëse në sistemin eternal në mënyrë që pjesa më e madhe e veprimeve të kryera në këtë system të mund të kontailizohet automatikisht.
Kjo gjë arihet nëpërmjet konfigurimeve të bëra në modulin e integrimit të sistemit Eterna.

Sistemi kryen veprimin në ditar për transaksionet automatikisht bazuar në skenarët e integrimit për secilin grup transaksioni dhe kod transaksioni (tra_group, Tra_code) të mare nga veprimet e kryera në sistemin eterna. Të gjitha skenarët e sistemit eterna mund të modifikohen në mënyrë që kontabilizimi i veprimeve të bëhet ashtu sic i kerkon posta shqiptare. Skenarët janë krijuar duke respektuar në të gjitha parimet e kontabilitetit sipas ligjit për institucionet financiare.

Kontabiliteti është qëndror për të gjithë posten. Drejtoria qëndrore duhet të kontrollojë dhe të instruktojë të gjithë palët e tjera përsa i përket veprimetarisë kontabël të institucionit.

Gjithashtu përmban skema të gatshme kontabilizimi edhe për pjesën tjeter të veprimeve: shitje, blerje, arkëtime/pagesa, magazina, si dhe listëpagesa, amortizimi etj. Të ketë mundësi që financierët mund të punojnë në të gjithë deget/zyrat e postes shqiptare njëkohësisht, pa asnjë kufizim apo përplasje të dhënash.
Veprimet nga sistemi Eterna bëhën të kontabilizuara sipas rregullave të postes shqiptare.
Sistemi ofron skemës e llogarive kontabel të postes të organizuara në një pemë duke filluar nga grupi i llogarive, nëngrupet e llogarive deri tek llogaritë analitike. Llogaritë duhet të jenë të koduara dhe të grupuara sipas manualit të kontabilitetit të te legjislacionit shqiptar për këtë lloj institucioni. Funksionet kryesore që duhet të kryhen janë si më poshtë:
• Shtimi i llogarive në tabelën ekzistuese
• Modifikimi i ndonjë llogarie ekzistuese.
• Heqja e llogarive nga skemën e llogarive.

- **Finance / Kontabilitet**

***Rregjsitrimi i veprimeve kontabel - Book keeping***

Pjesa më e madhe e transaksioneve të kryera në degët / zyrën e postes shqiptare nga sistemi eterna duhet te rregjistrohen automatikisht në llogaritë GL. Kjo gje arrihet nëpërmjet konfigurimeve të bëra në modulin e integrimit te sistemit Eterna.
Megjithatë, pavarësisht nga funksionaliteti e modulit më lart, ende mund të ekzistojnë mundesi që disa transaksione të duhet të futen manualisht.

Moduli i hedhjes manual të veprimeve në kontabilitet bën regjistrimet e tyre duke i organizuar në sesione të ashtuquajtura Baches. Nuk ka rregull të paracaktuar për mënyrën e grupimit të transaksioneve në një batch të caktuar. Varet nga kontabilisti që t'i grupojë dhe organizoje veprimet në mënyrën që dëshiron për një organizim më të mirë të tyre dhe për

lehtësi të punës së kontabilistit. Sapo hapet një bach/sesion, mund të bëhen veprime kontabël. Në fund te regjistrimit të veprimeve Batch /sesioni duhet të mbyllet. Pasi batch / sesion të jetë mbyllur, transaksionet e këtij batch nuk mund të modifikohen dhe gjithashtu transaksionet e tjera nuk mund të shtohen më tej në të.
Edhe veprimet kontabel që bëhen në mënyre automatike do të organizohet në bach-e / sesione
Duhet që cdo veprim kontabel të ketë një kod unik UGLN. Nqs veprimi kontabel lidhet me një veprim të të sistemit eternal ath UTN e veprimite të sistemit eternal duhet të përcaktohet në veprimin kontabel në një fushë të tij
Në këtë modul duhet të reflektohet gjithashtu edhe PostDate e sistemit Eterna

Mundesohet listimi i të gjithë sesioneve në mënyrë që më pas duke klikuar në njerin prej tyre të mund të shihen veprimet e rregjistruara në to.

Moduli i Blerjes– Rregjistron me lehtësi ciklin e plotë të blerjes në lek dhe në valutë të huaj, me doganë apo pa doganë, me llogaritje automatike të tvsh-se apo pa tvsh dhe gjithashtu të lejoje dhe për shkallëzimin e saj. Të rakordojë faturat me porositë, pagesat, hyrje-daljet si dhe të sinjalizojë për detyrimet. Të konfigurojë elementët përbërës të faturave si:

- Furnitorin - me të dhënat e tyre identifikuese dhe skemat kontabël.
- Afatet e maturimit për furnitorët dhe detyrimet e tyre.
- Raporte përkatëse për kontrollimin e maturimeve.
- Kategoritë e zbritjes
- Mundësi personalizimi dhe konfigurimi në ambientet e regjistrimit të faturave dhe çeljeve të furnitorëve sipas specifikave dhe kërkesave të ndërmarrjes.
- Formati i librit te blerjeve duhet të jetë i njëjtë me atë të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Moduli i Shitjeve – mundëson regjistrimin dhe ndjekjen e ciklit të shitjes duke regjistruar në ambiente specifike të gjitha transaksionet e shitjeve.Të konfigurojë elementët përbërës të faturave si:

- Klientët - me të dhënat e tyre identifikuese dhe skemat kontabël.
- Afatet e maturimit për klientët.
- Kategoritë e zbritjes.
- Mundësi personalizimi dhe konfigurimi në ambientet e regjistrimit të faturave dhe çeljeve të klientëve sipas specifikave dhe kërkesave të ndërmarrjes.
- Grupimin e dokumenteve sipas disa kritereve për nevoja të ndryshme.
- Formati i librit te shitjeve duhet të jetë i njëjtë me atë të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Moduli i Inventarit– Ky modul ofron funksione për mbajtjen e inventarëve nga pikëpamja fizike dhe ndjekjen e tyre në detaje për lëvizjet që janë bërë që nga momenti i blerjes, siç është hyrja në magazinë dhe lëvizjet nga njëra magazinë në tjetrën. Pasqyron në çdo moment gjendjen e inventarit duke njoftuar mbi stoqet apo mungesat në inventar. Të ketë ambient të veçantë për rivlerësimin e inventarit për rillogaritjen e çmimit (kostos) së artikujve në magazinë duke u nisur nga metodat teorike :metoda e çmimit mesatar të ponderuar, metoda FIFO, dhe kosto historike etj. Regjistron një numër të pakufizuar artikujsh më të dhëna të plota si: kod/kod bar, grupi i artikullit, deri në dy njësi matjeje, niveli i tvsh-së, furnitori, si dhe të dhëna të tjera shtesë si: pesha bruto dhe neto, origjina e mallit etj.

Integrimi i magazinave me modulet e shitjes te sistemit eterna

Ofrohet funksionimi i një point of sale për artikujt që shiten nga sportelet e postes shqiptare dhe për këto raste të preket gjëndja e magazinës përkatëse automatikisht.

Moduli i Arkës dhe Bankës- shërben për menaxhimin e likuiditeteve të ndërmarrjes. Ky modul duhet:

- Të regjistrojë arkëtimet, pagesat dhe lidhjet me faturat e pa likuiduara.
- Krijimin e listave të arkës dhe të bankave .
- Të bëjë lidhjen e dokumenteve. Për shëmbull lidhja e një fature me një mandat banke/arke, lidhja e një fature me një faturë tjetër etj
- Termat Tregtare
  a. Përcaktimi i afateve të maturimit për klientët/ furnitorët
  b. Termat tregtare të mund të përcaktojnë zbritjet në rast të pagesës Brenda termave apo zbatimin e kamatave ose normave te interest në rast të pagesave të vonuara.
  c. Raportet për arketimet dhe pagesat të pritshme në segmente kohore të modelueshme, të mund të gjenerohen automatikisht nga sistemi.

Moduli i Aseteve- Për menaxhimin sa më të mirë të aseteve, sistemi i menaxhimit të aseteve të funksionon mbi bazën e serialeve të aseteve. Seriali asetit është unik dhe identifikues për çdo aset të veçantë fizik. Funksionalitet që përfshihen ne kete modul janë:
Llogaritja e amortizimit- Llogaritja e amortizimit mund të bëhet sipas sipas kërkesave të tatim taksave (amortizim mbi vlerën e mbetur), ose sipas standardeve ndërkombëtare IFRS (psh mbi koston historike) etj. Llogaritja automatike e amortizimit të jetë e mundur të bëhet mbi bazë mujore ose ditore në varesi të kërkesave të konfigurimit që do ketë kompania. Amortizimi të mund të llogaritet mbi bazën e normës së grupit ose mbi bazën e jetëgjatësisë së aseteve.

<u>Grupimi i aseteve në grupe dhe nëngrupe</u>**.** Grupet dhe nëngrupet të mund të përdoren për të grupuar asetet më karakteristika të njëjta. Për secilin grup të mund të krijohen nëngrupe sipas specifikave të ndryshme.

<u>Krijimin e kartelës së asetit me të dhënat e plota të tij</u>**.** Kartela e asetit të përmbajë informacionet e përgjithshme për asetin si:

a) Një kod unik, alphanumerik.
b) Emërtimin e asetit.
c) Grupin e aseteve në të cilin bën pjesë.
d) Njësinë matëse, gjendjen Min/max, peshën etj.
e) Përveç informacioneve standarde, në kartelën e asetit, të mund të shtohen edhe fusha të tjera për shënimin e informacioneve më specifike.
f) Kartelës së asetit të mund ti bashkëngjiten dokumente të jashtëm, si imazhe, dokumente në excel, pdf etj., dhe çdo përdorues i autorizuar të mund të shohë këto informacione të bashkëngjitura.

Regjistrimi i gjithë veprimeve me asetetsi blerje, shpërndarja e shpenzimeve të doganës, e shpenzimeve të transportit, shitje, nxjerrje jashtë përdorimit e aseteve, transferimin e aseteve nga një vendndodhje në tjetër, rivlerësimin e aseteve, llogaritjen e amortizimit.

- **Moduli i Burimeve Njerëzore.**

<u>Funksionalitete të Modulit të Burimeve Njerëzore:</u>

a) Funksionalitet të përfshirjes së të gjithë komponentëve që ka aktualisht ky sistem, Moduli Eterna Burimet Njerëzore, si dhe duke përfshirë të gjithë elementët brenda këtyre komponentëve.

- Hierarkia e kompanisë
- Kontrata
- Shtesa në pagë
- Linja manaxhimi
- Strukturat
- Kategoritë e pagës
- Lidhja Pozicion Pune me Zyre
- Pozicioni I punës
- Frekuenca e pagesës
- Trajnime
- Pagat
- Punonjësit
- Departamentet
- Listëprezenca
- Konfigurim Leje-Performance
- Konfigurim i objektivave
- Shpenzimet e punonjësit

b) Funksionalitet të evidencave mbi listën e punonjësve të kompanisë, mbi pagat dhe kostot e lidhura me punonjësit dhe regjistrimin e listëpagesave nga kompania; të regjistrimit dhe gjenerimit të listëpagesës nga listëprezenca, në fund të çdo muaji.

c) Funksionalitet të raporteve që aktualisht ka sistemi, Moduli i Burimeve Njerëzore, konkretisht 37 raporte *(raportet e meposhtme)*, brenda një kohe 10’(10 minuta) nga koha e kërkimit të tyre, si dhe gjenerim të raporteve të reja, pas kërkesave që Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe nga kërkesave të Filialeve, lidhur me çështje të burimeve njerëzore, duke i mundësuar realizimin e tyre brenda 2 ditëve(48 orë) nga kërkesa e dërguar.

- ARPHR01-Punonjësi me të dhëna të përgjithshme
- ARPHR02-Lista emërore për gjithë kompaninë
- ARPHR03-Lista emërore në nivel strukture
- ARPHR04-Lista emërore në nivel filiali
- ARPHR05-Vendbanimi i punonjësve sipas qyteteve
- ARPHR06-Pozicionet e punës për gjithë kompaninë
- ARPHR07-Pozicionet e punës në nivel strukture
- ARPHR08-Pozicionet e punës në nivel filiali
- ARPHR09-Pozicionet e punës në nivel dege
- ARPHR10-Pozicionet e punës në nivel zyre
- ARPHR11-Punonjësit dhe pagat për gjithe kompaninë
- ARPHR12-Punonjësit dhe pagat në nivel strukture
- ARPHR13-Punonjësit dhe pagat në nivel filiali
- ARPHR14-Punonjësit sipas kategorisë për gjithë kompaninë
- ARPHR15-Punonjësit sipas kategorisë në nivel strukture
- ARPHR16-Punonjësit sipas kategorisë në nivel filiali
- ARPHR17-Vlerësimi i punonjësve për gjithë kompaninë
- ARPHR18-Vlerësimi i punonjësve në nivel strukture
- ARPHR19-Vlerësimi i punonjësve në nivel filiali
- ARPHR20-Masat disiplinore të punonjësve për gjithë kompaninë
- ARPHR21-Masat disiplinore të punonjësve në nivel strukture
- ARPHR22-Masat disiplinore të punonjësve në nivel filiali

- ARPHR23-Arsimi i punonjësve për gjithë kompaninë
- ARPHR24-Arsimi i punonjësve në nivel strukture
- ARPHR25-Arsimi i punonjësve në nivel filiali
- ARPHR26-Trajnimet e punonjësve për gjithë kompaninë
- ARPHR27-Trajnimet e punonjësve në nivel strukture
- ARPHR28-Trajnimet e punonjësve në nivel filiali
- ARPHR29-Pushimet vjetore të punonjësve për gjithë kompaninë
- ARPHR30-Pushimet vjetore të punonjësve në nivel strukture
- ARPHR31-Pushimet vjetore te punonjësve në nivel filiali
- ARPHR32-Vendet vakante në gjithë kompaninë
- ARPHR33-Vendet vakante në nivel strukture
- ARPHR34-Vendet vakante në nivel filiali
- ARPHR35-Punonjësit në moshë pensioni për gjithë kompaninë
- ARPHR36-Punonjësit në moshë pensioni në nivel strukture
- ARPHR37-Punonjësit në moshë pensioni në nivel filiali

**Funksionalitet e Posta Retail Outlet**
**Funksionet bazë të sistemit "Posta Retail Outlet"**

- Të krijohet një dyqan online.

- Të mund të ekspozoj produktet e këtij dyqani online nëpërmjet një ndërfaqe user-friendly.

- Artikujt duhët të kategorizohen për akses më të lehtë nga përdoruesi.

- Duhet të ketë një pamje ku jepen detajet e artikujve online.

- Klienti duhet të shtoj në shportë artikujt e zgjedhur.

- Klienti duhet të ketë mundesi të modifikoj shportën e tij të artikujve (duke ndryshuar sasitë e porisitura ose duke hequr fare artikuj nga shporta).

- Klienti duhet të ketë opsion për bërjen e pagesave online siç është detajuar më poshtë në këtë dokument.

- Sistemi duhet të ketë një funksionalitet workflow për menaxhimin e blerjeve të klientëve që nga porosia deri në dorëzim të blerjes.

- Të suportoj të gjithë monedhat që përdoren në sistemin Eterna.

- Të menaxhoj taksat për shitjet.

- Të menaxhoj procesin e transportit të produkteve të shitura.

- Përdoruesi të mund të krijoj profilin e tij online.

- Përdoruesi duhet të krijoj vetë kredencialet e tij.

- Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet duhet të jetë edhe për android dhe IOS.

- Dyqani online duhet të bëjë të mundur që Posta Shqiptare të mund të shesë online produkte të ndryshme të saj.

- Këto produkte duhet të reklamohen online nëpërmjet nje ndërfaqeje e cila duhet të jetë User_Friendly, për të bërë të mundur që klientët të mund të blejnë artikujt e tregëtuar online.

- Artikujt duhet të grupohen në kategori të ndryshme.

- Pasi përdoruesi klikon në një artikull duhet të hapet një faqe ku ndodhen të dhëna më të dëtajuara për këtë artikull.

- Përdoruesi duhet të ketë mundësinë që të shtoj në shport artikujt e zgjedhur prej tij.

- Pasi përdoruesi ka zgjedhur artikujt, duhet të ketë mundësinë për të ndryshuar sasitë për çdo artikull ose edhe për të hequr artikujt nga shporta e tij.

- Gjithashtu përdoruesi duhet të ketë mundësinë e pagesës së artikujve online. Metodat e pagesës jepen në vazhdim të këtij dokumenti.

- Klienti pasi konfirmon blerjen duhet të njoftohet personi përgjegjës i Posta Shqiptare në mënyrë që të nisë procesi i dërgimit të porosisë.

**Moduli i Work-Flow**

- Sistemi duhet të ofroj edhe një modul për krijimin e proceseve workflow.

- Duhet të krijohet një work-flow që të menaxhoj të gjithë procesin e trajtimit të blerjeve.

- Ky workflow duhet që të integrohet edhe me modulet e sistemit Eterna në mënyrë që të kryhet i plotë si proces.

- Në mënyrë që të akomodohet Work-Flow edhe nga sistemi Eterna duhet që edhe në këtë sistem të bëhen ndryshimet e nevojshme për ruajtjen e statusit te kërkesës etj.

**Moduli i pagesave**

“Dyqani Postar Online\Posta Retail Outlet” mbështet pagesat online dhe offline. Për metodat online Dyqani Postar Online\Posta Retail Outlet duhet të integrohet me Eterna Gateway Application. Duhet të bëhen modifikimet e nevojshme në modulin Eterna Gateway Application në mënyrë që të funksionojnë mënyrat e pagesës që do të ofrohen nga sistemi që janë si më poshtë:

1. E-wallet nga Posta Shqiptare.
2. Kartë krediti.
3. Paypal.
4. Me CASH on delivery.

Sistemi duhet të jetë multi currency. Duhet të suportoj të gjithë monedhat që Posta Shqiptare përdor. Për këtë qëllim e-commerce duhet të integrohet me sistemin core Eterna dhe të gjithë informacionin në lidhje me monedhat të meret nga Eterna.

**Modifikimi i modulit të Financës në sistemit Eterna.**

Të gjithë veprimet e bëra nga moduli Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet duhet të kontabilizohen. Duhet të modifikohet moduli kontabël i sistemit Eterna në mënyrë që të kontabilizoj veprimet financiare të gjeneruara nga Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet.

**Modifikimi i modulit të magazinës të sistemit Eterna**

Sistemi Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet duhet të përdor modulin e magazinës së sistemit Eterna për menaxhimin e mallit në magazinë. Për këtë qëllim ky modul i sistemit Eterna duhet të modifikohet në mënyrë që ti shërbej Posta Retail Outlet.

**Menaxhimi i taksave.**

Për të përcaktuar taksat e faturave të shitjes duhet të shtohen funksione në sistemin Eterna në mënyrë që përveç taksava që menaxhohen për sistemin financiar ti shërbej edhe taksave që do të mbahen për klientët që do të bëjnë blerje nga Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet.

Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet duhet të integrohet me modulin Eterna dhe menaxhimi i taksave për faturat e shitjes do të bëhet nga funksionet e sistemit Eterna.

**Moduli i transportit.**

Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet duhet të ketë funksionet e nevojshme që të ofroj shërbimin e shpërndarjes së pakove.

Klienti duhet të vendos adresën se ku duhet të dorëzohet pako. Sistemi duhet të llogarisë automatikisht çmimin e transportit. Për llogaritjen e çmimit të transportit Dyqani Postar Online\Posta Retail Outlet duhet të integrohet me modulin postar dhe me funksionalitetet që janë përgjegjëse për llogaritjen e çmimeve të transportit.

Gjithashtu edhe moduli postar i sistemit Eterna duhet të modifikohet që të mbështes modulin e transportit të sistemit Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet.

Vendodhja e mallit nga do të bëhet transporti meret nga magazina në të cilën ndodhet malli.

**Moduli i identifikimit dhe authentikimit të përdoruesve**

Duke marrë parasysh se informacioni që do të publikohet është konfidencial, duhet të zbatohen masa shtesë për të mbrojtur konfidencialitetin dhe integritetin e informacionit të tillë.

Duhet të implementohet një autentikim i sigurt për aksesimin e sistemit.

Identifikimi dhe authentikimi do të menaxhohet në bashkëpunim me Modulin e të Drejtave të sistemit Eterna dhe do të kërkohet që të plotësojnë kriteret e kompleksitetit të konfiguruara nga administratorët e aplikacionit Eterna.

**Modifikimi i sistemit Eterna në mënyrë që të funksionoj Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet**

Duhet të bëhen ndryshimet e duhura në sistemin Eterna që të realizoj shkëmbimin e informacionit midis sistemit Core Eterna dhe Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet. Modifikimet në sistem duhen bërë për të gjithë funksionet që do të kërkojnë ndërveprimin midis sistemit Core Eterna dhe Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet. Siguria është një tipar tjetër që do të konsiderohet seriozisht gjatë zhvillimit të ketyre ndryshimeve për të siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë.

**Ndryshimet në Eterna Web Log Management Module**

Sistemi duhet të jetë në gjendje të gjenerojë logs për veprimet e kryera nga përdoruesi në të.

Logs do të përdoren për të vërtetuar aktivitetin e përdoruesit. Për këtë qëllim do të përdoret modul i logeve të sistemit Eterna në të cilin do të vendosen edhe log të sistemit Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet.

**Integrim me Modulin e njoftimeve Eterna Queue**

Moduli mesazhe / email do të përdoret për të dërguar njoftime të ndryshme për ngjarje të ndryshme që gjenerohen në sistem, si ndryshimi i fjalëkalimit etj.

Si pjesë e modulit të njoftimeve është gjithashtu një ndërfaqe me kompanitë që ofrojnë shërbime SMS. Mesazhet duhet të vendosen në modulin Eterna Queue. Ky modul është përgjegjës per dërgimin e tyre.

**Integrimi me modulin e dhënies së të drejtave në Eterna**

Nëpërmjet këtij moduli përdoruesit do të krijohen / aprovohen në sistem dhe gjithashtu do të vendosen të drejtat që ata do kenë.

Funksionet për dhënien e të drejtave në këtë modul do të shtohen tek moduli i dhënies së të drejtave që ndodhet në sistemin Eterna dhe gjithashtu do të përdoren dhe funksionet ekzistuese të këtij sistemi.

Sistemi duhet të suportoje gjuhë të ndryshme. Për këtë qëllim duhet të ketë një opsion për të zgjedhur gjuhën Default të Dyqani Postar Online \ Posta Retail Outlet. Duhet të ketë mundësi të shtohen gjuhë të reja nqs do të duhen nga institucioni.

**<u>Funksionalitet e Buzines Hub</u>**

Posta Shqiptare operon prej vitesh nëpërmjet nje sistem informatik te avancuar per ofrimin e shërbimeve financiare dhe postare ne deget e saj ne te gjithë Shqipërinë. Nepermjet ketij sistemi procesohen nje numer i madh transaksionesh. Ky sistem eshte gjithashtu i integruar

pothuajse me te gjithë institucionet Shqiptare te cilan operojnë nëpërmjet sistemeve informatike duke shkëmbyer informacion ne kohe reale. Gjithashtu ky sistem ofron mbajtjen e llogarive nëpërmjet shërbimit e-wallet, pagesave online dhe transferta monetare

Nëpërmjet Business Hub kryhet shtimi i komponentëve te meposhtem ne funksionet ekzistuse te sistemit informatik te Postes Shqiptare per te ofruar nje game te gjere shërbimesh per kliente nëpërmjet modifikimeve ne modulin E-posta i cili ofron mbajtjen e llogarive virtuale per kliente dhe gjithashtu ofron pagesa online nëpërmjet këtyre llogarive, integrimi me sistemet e tjera te cilat mbajnë te dhënat (sic eshte databasa e studenteve)

Platforma Informatike e Postes Shqiptare zotëron komponentë te tille te cilët te integruar me disa funksione shtese mund ta bëjnë kete shërbim te mundur ne nje kohe te shkurter

Sistemi ofron sherbime te integruar me sistemin e Postes Shqiptare dhe eshte i perbere nga disa komponente kryesore:

**Databaza e klientëve**

Kjo database eshte burimi primar nga i cili do te verifikohen te dhenat e klientit dhe nga e cila do te percaktohet nese nje person do te klasifikohet si klient preferencial i cili përfiton shërbime me kosto me te ulet apo jo, dhe rrjedhimisht do te perfitoje apo jo nga zbritjet e aplikueshme per kategorine perkatese. Rregullat e percaktimit te klienteve preferenciale percaktohen ne momentin e duhur, por disa nga parametrat percaktues qe duhet te merren per baze jane si me poshte:

1. Kategoria e vecante e klienteve (psh studentet, pensionistet, invalide, stafi i Postes etj…). Data Bazat e klienteve te vecante do te azhornohen me institucionin pergjegjes.
2. Numri dhe volume i pagesave qe kryen klienti
3. Volumi i depozitimeve te kryera ne llogarine e-posta

**Komponenti i ofrimit te sherbimit per klientet**

Nepermjet aplikimit ePosta kliente pasi te regjistrohen/aprovohen do te kene mundesine te perfitojne te gjithe gamen e benefiteve te ofruara per ta.

Per sherbimet qe ofrohen nga Posta Shqiptare do te kete trajtim specifik per kategorine e ndryshme te klienteve duke ofruar ulje ose zerim tarifash/komisionesh. Keto sherbime do te ofrohen te gjitha nepermjet perdorimi te portofolit dixhital.

Shërbimet e tjera do te jene gjithe grupi i sherbimeve potenciale te cilat do te ofrohen per kategorine e klienteve. Si shembull mund te permendet

- Uljet cmimesh per kinema
- Ulje cmimesh per library
- Ulje cmimesh nga kompani private
- Transporti urban
- Etj etj

Zgjidhja eshte e tille qe numri i sherbimeve ne kete kategori te jete i pa kufizuar. Pra kushdo ofrues shërbimi (merkant) do te mund te aplikoje ne kete skeme dhe te ofroje sherbimin me reduktim tarifash.

Kjo mundesohet nepermjet perdorimi te komponentes aktuale E-posta ne kete menyre:

Cdo kategori klienti do te kete mundesi te gjeneroje nje kod (kupon) nga aplikimi. Numri i kodeve do te jete i percaktuar sipas marreveshjes me palen e trete. Psh 1 ne jave. Cdo klient do te mund te gjeneroje kete kod (numerik dhe QR) nga aplikimi. Ky kod do te jete i vlefshem dhe i aplikueshem te pala e trete (merkanti) per te mundesuar zbritjen ne fjale. (ne vazhdim komponenti 3)

**Komponenti i ofrimit te sherbimit per tregetaret**

Posta Shqiptare ka ndertuar funksione te integruar me Sistemin Posta retail outlet (e-commerce) te i cili cdo pale e trete qe do jete ofrues sherbimi per klientet preferencal do te mund te aksesoje llogarine e saj. Ne kete protal cdo tregetar ka mundesine

1. Te hedhe ofertat ne sistem per segmente te ndryshem klientesh me zbritjet perkatese
2. Te skanoje kuponat e gjeneruar nga klienti preferencal nga komponenti i hapit 2. Skanimi i kodit do te jete prove qe ky klient ka gjeneruar nga Posta Shqiptare marrjen e sherbimit me kosto te reduktuar. Ne kete moment, me perdorimin e tij ky kod behet i pavlefshem dhe klienti i ofrohet sherbimi me perfitime (sipas cdo rasti). Psh: nje zbritje prej 200ALL ose 10% nga bileta e kinemase ose per cdo dy produkte te blera i treti te jete falas. Kompanive i jepen te gjitha sherbimet e nevojshme per rakordim apo analizim mbi numrin e kuponave te ofruar, cmimet, klientet qe i perfituan keto kupona etj etj

Praktikisht kjo skeme mund ti ofrohet cdo pale te trete e cila deshiron te ofroje nje plan zbritjesh mbi nje grup te caktuar personash.

Disa nga nderveprimet e mesiperme me palet e treta realizohen nepermjet platformes EternaGateway te Postes Shqiptare

Per kete qellim jane shtuar modulet/funksionet e meposhtme:

1. Databaza e klientëve preferencial ne përputhje me kategorinë perkatese
2. Moduli i ofrimit te sherbimit per tregetaret
3. Moduli i ofrimit te sherbimit per Klientet
4. Lista e tregetareve te perfshire ne skeme
5. Lista e klienteve qe perfitojne nga skema e uljeve
6. Integrimi me systemin e pagesave e-wallet
7. Muduli per hedhjen e ofertave per segmente te ndryshme klientesh
8. Integrimi I Muduli per hedhjen e ofertave per segmente te ndryshme klientesh me e-commerce
9. Integrimi me e-albania per te mundesuar pagesat e sherbimeve qeveritare nepermjet e-wallet
10. Ndryshimet e nevojshme ne Eterna •b Log Management Module
11. Integrimi me modulin e njoftimeve ne Eterna
12. Integrimi me modulin e dhënies se te drejtave ne Eterna

13. Shtimi I funksioneve te duhura per te plotesuar nevojat e mesiperme tek Eterna Financiare
14. Aprovimi i pagesave nga moduli e-posta
15. Rest Api Per tarifat postare
16. Rest api per integrimin e kontrollit te kuponave nga sistemet e tregetareve

**Detaje per modulet**

**Databaza e klienteve preferencial**

Kjo database eshte burimi primar nga i cili do te verifikohen te dhenat e klientit preferencal dhe nga e cila percaktohet nese nje person do te klasifikohet si klient preferencial apo jo, dhe rrjedhimisht do te perfitoje apo jo nga zbritjet e aplikueshme per kategorine perkatese. Databaza azhornohet/sinkronizohet me institucionet pergjegjes si psh ne rastin e studenteve.

Databasa mund te krijohet nepermjet njeres nga dy menyrave te meposhtme:

1. Duke importuar te dhenat per klientët preferencal ne sistem nepermjet skedareve (excel) qe Posta shqiptare merr ne format elektronik nga institucionet perkatese.
   Sistemi duhet te mundesoje importimin e ketyre listave nga punonjesit e postes.
   Pas importimit te listave, sistemi duhet te jete ne gjendje te shfaqe informacionin per klientët preferencal te importuar ne formen e listave,
   Te kerkoje sipas emerit, mbiemrit, NID ne listat e klientëve preferencial,
   Te shfaqe rezultatin e kerkimit,
   Te mundesoje leximin e te dhenave te tjera te klientit preferencal, pasi te zgjidhet nje klient specific dhe te klikohet funksioni “Detaje”
2. Nëpërmjet nderfaqesimit te sistemit te postes shqiptare me sistemin qe menaxhon databasen e klienteve preferenciale.
   Sistemi mundeson funksionet e meposhtme mbi listen e klienteve te importuar ne system:
   Pas nderfaqesimit, te kërkojë sipas emerit, mbiemrit ne listat e klienteve,
   Te shfaqe rezultatin e kerkimit,
   Leximin e te dhenave te tjera te klientit, pasi te zgjidhet nje klient specific dhe te klikohet funksioni “Detaje”
   Ne menyre qe te realizohen funksionet e mesiperme duhet qe nderfaqja e institucionit qe menaxhon database e klienteve te ofroje funksionalitetet per te mundesuar keto funksione, ne te kundert do te mundesohet vetem funksionet e mesiperme qe mund te akomodohen nga nderfaqja.
   Ne kuader te nderfaqesimit automatik Posta Shqiptare ofron nje sherbim API i cili i mundeson autoritetit qe menaxhon databazen klienteve te postoje ne cdo kohe
   a) Shtimin e nje klienti te ri ne sistemin e Postes Shqiptare
   b) Modifikimin e nje klienti ekzistues
   c) Caktivizimin apo fshirjen e nje klienti
3. Nëpërmjet kategorizimit të klientëve ekzistues të cilët zotërojnë një protofol elektronik në klientë preferencial. Për të realizuar këtë funksionalitet duhet që
   a. Ti lejohet punonjësit të autorizuar të Postës Shqiptare të kategorizojë klientin bazuar mbi procedurat e caktuara
   b. Ti lejohet punonjësit të autorizuar të Postës Shqiptare të heqi klientin nga kategorizimi si klient preferencial

c. Të replikoje cdo veprim që ndodh me klientin si çaktivizim apo bllokim në databazen e klientëve preferencial

**Moduli i ofrimit te sherbimit per tregetaret**

Posta Shqiptare ka ndertuar funksione te te cilat cdo pale e trete qe do jete ofrues sherbimi per klientet do te mund te aksesoje llogarine e saj. Jane bere modifikimet e nevojshme tek moduli Posta Retail Outlet (e-commerce) ne menyre qe te mundesohen hedhjet e ofertave. Cdo tregetar do te kete mundesi:

1. Te hedhe ofertat ne sistem per segmente te ndryshem klientesh me zbritjet perkatese
2. Te skanoje kuponat e gjeneruar nga klientët preferencialë dhe studentet (pra aplikimi ePosta ose sportelet e Postes Shqiptare). Skanimi i kodit do te tregoje qe personi eshte autorizuar per marrjen e sherbimit me kosto te reduktuar. Ne kete moment, me perdorimin e tij ky kod behet i pavlefshem dhe klientet ose studentet i ofrohet sherbimi me perfitime (sipas cdo rasti). Psh: nje zbritje prej 200ALL ose 10% të vlerës nga bileta e kinemase ose per cdo dy produkte te blera i treti te jete falas. Kompanive do ti jepen mundesite per rakordim apo analizim mbi numrin e kuponave te ofruar, cmimet, klientet qe i perfituan keto kupona etj

**Moduli i ofrimit te sherbimit per klientet**

Tek aplikimi e-Posta do te shtohet nje funksionalitet qe do te quhet Ofertat e mia. Nga ky modul do te mund te aksesohen ofertat qe hidhen tek portali i tregetarit.

Nëpërmjet aplikimit ePosta kliente dhe kategori te tjera specifike si studentet etj pasi te regjistrohen/aprovohen do te kene mundesine te perfitojne te gjithe gamen e benefiteve te ofruara per ta.

Për sherbimet qe ofrohen nga Posta Shqiptare do te kete trajtim specifik per kategorite e caktuara te klienteve duke ofruar ulje ose zerim tarifash/komisionesh. Keto sherbime do te ofrohen nepermjet perdorimi te portofolit dixhital te aplikimit ePosta.

Zgjidhja do te jete e tille qe numri i sherbimeve ne kete kategori te jete i pa kufizuar. Pra kushdo ofrues sherbimi (merkant) do te mund te aplikoje ne kete skeme dhe te ofroje sherbimin me reduktim tarifash per studentet. Kjo do te mundesohet duke bere modifikimet e nevojshme te aplikacioni aktuale ePosta ne kete menyre:

Cdo klient preferencial dhe student do te kete mundesi te gjeneroje nje kod (kupon) numerik dhe QR nga aplikimi per sherbimet qe do te porosise. Numri i kodeve do te jete i percaktuar sipas marreveshjes me palen e trete. Psh 1 bilete kinemaje me 50% ulje ne jave. Cdo klient preferencial apo student do te mund te gjeneroje kete kod (barkod) nga aplikimi. Ky kod do te jete i vlefshem dhe i aplikueshem te pala e trete(merkanti) per te mundesuar zbritjen ne fjale.

**Lista e tregetareve**

Sistemi duhet te mundesoje listen e tregetareve (kompanive) qe jane pjese e BusinessHUB.

Sistemi duhet te jete ne gjendje te shfaqe informacionin per kompanite ne formen e listave,

Te kerkoje sipas emrit te kompanise,
Te kerkoje sipas NIPT-t
Te shfaqe rezultatin e kerkimit,
Te mundesoje leximin e te dhenave te tjera te kompanise, pasi te zgjidhet nje kompani specifike

**Lista e klienteve**

Sistemi duhet te mundesoje listen e klienteve qe jane pjese e BusinessHUB,
Sistemi duhet te jete ne gjendje te shfaqe informacionin per klientin ne formen e listave,
Te kerkoje sipas emerit te klientit,
Te kerkoje sipas NID te klientit
Te shfaqe rezultatin e kerkimit,
Te mundesoje leximin e te dhenave te tjera te klientit, pasi te zgjidhet nje klient specifik.

**Integrimi me sistemin e pagesave e-wallet**

Nepermjet aplikimit ePosta kliente dhe kategori te tjera specifike si studentet, pensionistet etj do te mund te aksesojne modulin Ofertat e Mia. Pasi te regjistrohen/aprovohen do te kene mundesine te perfitojne te gjithe gamen e benefiteve te ofruara per ta. Nga integrimi me sistemin e pagesave e-wallet, klientet do te mund te paguajne per keto sherbime duke perdorur llogarine e-wallet qe ata mund te kene te Posta Shqiptare.

Klientet mund te paguajne me e-wallet per sherbimet tek Ofertat e Mia

Cdo kategori klienti, psh student pervec se do te kete mundesi te gjeneroje nje kod(kupon) nga aplikimi ePosta per sherbimet qe do te porosise, gjithashtu do kete mundesin ti paguaj ato me llogari e-wallet. Pra do te jene te aplikueshme te dyja metodat e pageses si me poshte

1. Paguan direkt me e-wallet.Ne kete menyre konsumohet edhe kuponi/oferta/barkodi.
2. Paguan ne sportelet e merkantit(tregetarit) duke paraqitur barkodin/kuponin qe eshte gjeneruar te ePosta.

**Moduli i kategorizimit, pikezimit dhe i besnikerise per klientet**

Per te mundesuar hedhjen e ofertave tek moduli duhet te behen shtimi i funksioneve te meposhtme:

Krijimi i Labels per klientet

Labels do tju shtohen klienteve dhe do perdoren per kategorizimin e tyre

Label do perdoren per te organizuar dhe per te selektuar nje nengrup te caktuar klientesh. Ne kete menyre do te behet segmentimi i klienteve. Cdo label do te kete Key dhe Value. Rregullat e percaktimit te Key dhe Value do te bazohen mbi aktivitetin e klientit me e-posta duke perfshire (por jo kufizuar) numrin dhe volumin e pagesave, depozitimeve.

Levels / Nivele

Nepermjet niveleve sistemi do të mundesoje se si të krijohen dhe përdoren nivelet tek klientet për të krijuar mundësine e zbritjeve dhe shpërblime të synuara bazuar në keto nivele.

Sa më shumë pikë që marrin klientët, aq me i larte eshte niveli qe ata mund te arijne dhe sa më i lartë niveli i besnikërisë, aq më shumë shpërblime do të mund te marrin klientët.

Tregetaret mund të përdorin nivele për të ofruar stimuj të klientëve, të tilla si:

• caktoi një shpërblim fiks në nivelin e veçantë. Niveli më i lartë - shpërblimi më i mirë

• ofrojnë shpërblime të veçanta në kohë të kufizuar për klientët të caktuar në një nivel të veçantë

Piket per cdo klient

Ky funksion shfaq piket e fituara nga cdo klient. Ky funksion jep gjithashtu mundesine për të ndjekur menyren se si keto pike jane fituar.

Rregullat e fitimit te pikeve

Rregullat e fitimit përcaktojnë mënyrat dhe kushtet që klientët duhet te plotesojne qe të fitojnë pikë.

Pikët mund të jepen për transaksione blerje te klienteve. Sistemi do te jape mundesine e vendosjes se pikeve qe fitohen per cdo blerje.

Mund të shtohen funksione të përjashtimit te blerjes se disa produkteve nga fitimi i pikeve.

Klientët mund të paguajnë me pikët, bazuar në kushtin (pikët te konvertuara ne vlere monetare) që tregetari vendos.

**Integrimi i Modulit per hedhjen e ofertave per segmente te ndryshme klientesh me e-commerce**

Moduli e-commerce eshte modifikuar ne menyre te tille qe te lejoje hedhjen e ofertave per segmente te ndryshme klientesh. Ne kete menyre mund te ofrohen oferta edhe per produktet qe tregetohen ne Posta Retail Outlet.

**Integrimi me e-albania per te mundesuar pagesat e sherbimeve te ofruara ne e-albania nepermjet e-wallet.**

Ne sistem jane bere ndryshimet e nevojshme ne menyre qe te ofrohet pagesa me e-wallet per sherbim qe ofrohen nga e-Albania. Per te realizuar kete do te duhet qe e-Wallet te procesoje pagesat si meposhte:

- Nje pale si perfituese e pageses hap nje llogari e-Wallet dhe ka mundesi ta ofroje dhe implementoje e-Wallet si menyre pagese ne cdo platform (ne kete rast e-Albania)
- Nje klient qe ka e-Wallet mund te beje pagese te pala me siper per cdo produkt/sherbim qe ajo ofron bazuar ne marreveshje perkatese te Posta Shqiptare dhe institucioneve/operatoreve që ofrojnë sherbimin.

- Ne kete nderveprim te mund te behet kalimi i parave nga klienti qe merr sherbimin/produktin te pala qe perfiton pagesen
- Ne kete nderveprim te mund te mbahet nje komision (ose jo) ne varesi te konfigurimit dhe marreveshjes qe do kete Posta Shqiptare me kete pale

**Ndryshimet ne Eterna Log Management Module**

Funksionet qe do shtohen duhet të jetë në gjendje të gjenerojë logs për veprimet e kryera nga perdorimi i tyre.

Logs do të përdoret për të vërtetuar aktivitetin e përdoruesit. Per kete qellim do te perdoret modul i logeve te sistemit eterna ne te cilin do te vendosen edhe log e gjeneruar nga perdorimi i ketyre funksioneve.

Loget duhet te gjenerohen, te perpunohen dhe te dergohen per tu ruajtur ne databazen e logeve qe eshte pjese e sistemit Eterna.

**Integrim me Moduli e njoftimeve Eterna.**

Moduli mesazhe / email do të përdoret për të dërguar njoftime të ndryshme qe do gjenerohen nga funksionet e reja te ketij sistemi.

Gjatë projektit do të vlerësohet nevoja për alarme të tjera të sigurisë të përdorura për sigurimin e duhur të mjedisit.

**Integrimi me modulin e dhënies se te drejtave ne Eterna**

Funksionet per dhënie e te drejtave nga zhvillimet e kerkuara ne kete procedure per te gjitha implementimet qe do behen ne sistemin Eterna Financiare do te shtohen tek moduli i Access right te sistemit dhe gjithashtu do te perdoren dhe funksione ekzistuese te këtij sistemi.

**Aprovimi i pagesave nga moduli e-posta, siguria me 2 nivele**

Cdo veprim qe do te preke e-walletin e nje perdoruesi do duhet te marre konfirmim nga vete perdoruesi per tu autorizuar. Pra neqoftese nje perdorues eshte duke kryer nje pagese ne nje sistem te trete (psh sipas specifikimeve te pikes 9) ose te ePosta ai do te duhet te aprovoje veprimin ne pajisjen e tij mobile.Per aprovimin e pagesave duhet te shtohen funksione si meposhte:

1-Ne momentin qe kofirmohet pagesa ne platformen dergohet kerkese ne backendin e ePostes (faqja qendron en gjendje pritje per marrje statusi mbrapsht)

2-backendi gjeneron nje notification per pajisjen mobile qe ka ky perdoreues ose te sugjeron ta instalosh neqoftese ne kete moment nuk ke nje te tille.

3-Ne pajisje:

- fut kodin e sigurise ose
- biometri

4-Kodi i sigurise ose biometri e suksesshme kalojne nje kerkese tjeter ne backend, qe aprovon veprimin.

5-faqja do te jete ne pritje te ketij veprimi dhe vazhdon proceduren ne rast suksesi

Kjo procedure rrit sigurine e pagesave me e-wallet dhe ben te mundur qe vetem personi qe zoteron pajisjen mobile te aprovoje pagesen qe po kryhet me llogarine e tij.

**Rest API per tarifat Postare**
Eshte shtuar nje nderfaqe qe te mundesoje qe tregetare te ndryshem te mund te marin nepermjet kesaj nderfaqe tarifat postare per objekte te ndryshme qe duan te dergojne me Posten Shqiptare.

**Rest API per integrimin e kontrollit te kuponave nga sistemet e tregetareve**

Eshte shtuar nje nderfaqe qe t'ju mundesoje sistemeve te tregetareve te lidhen me BusinessHub dhe te skanojne kuponat e gjeneruar nga sistemi I tyre.
Kjo realizohet ndermje nje nderfaqe RestAPI qe do lidhe kete funksion te BusinessHub me systemin e klientit.
Nderfaqja do jete standarte per te gjithe tregetaret (te njejtat funksione per te gjithe tregetaret).

**<u>Funksionalitet e e-Posta</u>**

Me platformën Dixhitale e-Posta kërkohet të kryen nëpërmjet kompjuterit, smartphone-it ose tabletit veprimet e mëposhtme:

- Regjistrimi online i profilit të klientit.
- Krijimi nga vetë përdoruesi i kredencialeve të tij.
- Lidhja me profilin e klientit të kontratave dhe shërbimeve të klientit (kontratë e energjisë elektrike, ujit, pagesa gjobash, pagesa taksa bashkie etj)
- Të mundësojë pagesën e faturave të energjisë elektrike, ujësjellës, pagesa gjobash, taksash etj që ofrohen si shërbime nga Posta Shqiptare.
- Kontrolli në kohë reale dhe në mënyrë të sigurt të të gjitha veprimeve financiare dhe postare.
- Transferta parash.
- Regjistrimi i Pre-beneficiary accounts për transferimin e fondeve.
- Aksesim i sistemit e-Posta nga web, mobile.
- Nga sistemi duhet të gjenerohet një statement i veprimeve të kryera
- Aplikacioni duhet të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit që do të menaxhojë përmes masave specifike të sigurisë së informacionit.

Aplikacioni e-Posta Web / mobile duhet të zhvillojë modulet e listuara më poshtë:

1. Funksionet bazë të aplikacionit e-Posta Web / Mobile
2. Identifikimi dhe autentifikimi i përdoruesve
3. Modifikimi i sistemit Eterna në mënyrë që ti shërbeje modulit e-Posta web / mobile.
4. Ndërfaqësi me bankë të nivelit të dytë për kryerjen e pagesave online

Më poshtë jepen kërkesat për secilin modul:

***Funksionet bazë të aplikacionit e-Posta Web / Mobile***

- Krijim profili nga përdoruesi.
- Duhet të dërgohet tek klienti njoftim për krijimin e profilit
- Duhet të integrohet me modulin Eterna të shërbimit Postar në mënyrë që përdoruesi të kontrollojë veprimet postare të kryera në sportelet e Posta Shqiptare.
- Të mund të shihet historiku i veprimeve
- Të mundësojë marrjen e lajmërimeve të dërguara nga posta drejt klientit
- T'i ofrojë klientit alternativë për të plotësuar kërkesa / ankesa
- Të mund të bëhet gjurmimi i objekteve dhe të njoftohet me mesazh për ecurinë e tyre deri në momentin final të dorëzimit në mënyrë automatike.
- Klienti të njoftohet për veprimtarinë e transaksioneve të transfertave që ka bërë në Postën Shqiptare
- Ky aplikacion duhet të ketë një modul që te jetë i aksesushëm nga postierët dhe të mundësojë menaxhimin e proçesit të dorëzimit të pakove.
- Aplikacioni mobile duhet të jetë i përshtatshëm për sistemet Android, iOS

***Moduli i identifikimit dhe autentifikimit të përdoruesve***

- Duke marrë parasysh se informacioni që do të publikohet është konfidencial duhet të merret në konsideratë qe aplikacioni e-Posta garanton ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së tij.
- Implementim i një autentifikimi të sigurt për aksesimin e sistemit.

***Modifikimi i sistemit Eterna ne mënyre që t'i shërbejë modulit e-Posta web / mobile***

- Aplikacioni Eterna eshte modifikuar në mënyrë që të suportojë të gjithë funksionet e sistemit e-Posta. Transaksionet e sistemit e-Posta do të ekzekutohen nga sistemi Eterna.
- Aplikimi duhet të gjenerojë logs për veprimet e kryera nga përdoruesi në sistem.
- Duhet qe këto log te integrohen brenda modulit Eterna web log
- Duhet te përdoret modulit Eterna Queue për dërgimin e mesazhe / e-mail, dhe për të dërguar njoftime për ngjarje të ndryshme që gjenerohen në sistem, si p.sh. ndryshimi i fjalëkalimit etj.
- Pjesë e modulit SMS eshte gjithashtu një ndërfaqe me kompanitë që ofrojnë shërbime SMS.
- Mesazhet jane lidhur me modulin Eterna Queue. Ky modul eshte përgjegjës për dërgimin e tyre.

***Ndërfaqësi me bankë të nivelit të dytë për kryerjen e pagesave online***

Mundesohet pagesa online te faturave për kompanitë e ndryshme si: OSHEE, Albtelecom, kompanitë e furnizimit me ujë, gjobat e makinave etj që ofrohen si shërbime nga Posta Shqiptare.

Moduli perfshin një ndërfaqe me një nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri (aktualisht Credins bank) në mënyrë që të bëjë proçesin e pagesave.

**<u>Specifikikat e Eterna BI, Datawarehouse dhe Log Management</u>**

Platforma është një magazine të dhënash (Data Warehouse), inteligjencë biznesi (Business Inteligence) dhe administrim logesh (Log Managament) që shërben si një burim kryesor raportimi dhe analize për punonjësit e Postës Shqiptare sh.a.

1. Data Warehouse bazohet mbi një platformë që është në gjendje të ngarkojë, transformojë dhe integrojë të dhënat e databazave operacionale të Postës Shqiptare, të sistemit Eterna.
2. Të gjitha transformimet dhe integrimet bëhen në mënyrë automatike, pa ndërhyrje njerëzore.
3. Data Warehouse mundëson organizimin e të dhënave nga databazat operacionale, në mënyrë të konsoliduar dhe të standartizuar, duke e bërë të mundur vendimarrjen e postës ndërmjet mjeteve analitike dhe raportuese.
4. Modeli i databazës bazohet mbi skema dimensionale dhe faktike, duke marrë informacionin e vlefshëm nga databazat operacionale për të gjitha shërbimet financiare dhe postare të sistemit ETERNA.

4.1 Për shërbimin e OSHEE, është kaluar në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksionive të OSHEE ( arkëtim, kamat vonesa, komision), koha e ekzekutimit të veprimit (ditë, muaj, vit), dhe në fakte vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.2 Për shërbimin e Ujësjellësit është kaluar në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksionive të ujësjellësit ( arkëtim, kamat vonesa, komision), kodet e institucioneve të bashkive për të cilat bëhen pagesat, koha e ekzekutimit të veprimit (ditë, muaj, vit), dhe në fakte vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.3 Për shërbimin e gjobave është kaluar në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksionive të gjobave (arkëtim, kamat vonesa, komision), kodet e institucioneve, koha e ekzekutimit të veprimit ( ditë, muaj, vit), dhe në fakte vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.4 Per shërbimin e doganave është kaluar në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksioneve të doganave (TVSH, komisionet, Tarifë Doganore si dhe tipe të tjera transaksionesh të lidhura me këtë shërbim), biznes ose individ për të cilin është bërë veprimi doganor, koha e ekzekutimit të veprimit (ditë, muaj , vit), dhe në fakte vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.5 Per shërbimin e taksave të bashkisë, është kaluar në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksioneve të taksave të bashkisë (komisione, taksë për zënien e hapësirës publike, taksë pastrimi si dhe të gjitha transaksionet për llojet e taksave që mbulohen nga ky shërbim), kodi vendor, koha e ekzekutimit të veprimit (ditë, muaj, vit), dhe në fakte vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.6 Për shërbimet postare është kaluar në dimensione karakteristikatat e objektit postar, tipi i transportit, mënyrat e pranimit, institucionet, shërbime të veçanta dhe në fakte numri i objekteve si dhe tarifat e arkëtuara

4.7 Per shërbime postare është kaluar në dimensione të gjitha ngjarjet e objekteve postare, si dhe koha e ekzekutimit të tyre, dhe në fakt numri i veprimeve.

4.8 Per shërbimet postare është kaluar në dimensione tipet e thasëve, ngjarjet e thasëve, transportet e thasëve dhe ngjarjet e lidhura me transportin e thasëve.

5. Perdorimi një tools-i (Power BI) për të gjithë përdoruesit e biznesit që mundëson krjimin e raporteve dinamike nga vetë përdoruesit e sistemit.
6. Tools-i mundeson lidhjen me databazën Data Warehouse, dhe mundeson që marrja e informacionit të bëhet në mënyrë direkte duke pyetur databazën ose të ngarkohet në mënyrë offline që raporti të përdoret në mënyrë të pavarur edhe pa lidhje direkte me databazën.
7. Mundeson përdoruesin e biznesit që të përgatisë dhe të modelojë informacionin në mënyrë të pavarur duke i lejuar atij përthithjen, transformimin e mëtejshëm , integrimin dhe pasurimin e informacionit të Data Warehouse.
8. Mundeson përdoruesit e biznesit që të gjejnë faktorët në ndryshimet në periudha të ndryshme kohore, ndërmjet funksionaliteteve si grupime, parashikime dhe clusterizime.
9. Ndërmjet përdorimit të templateve të gatshme mundeson përdoruesin që të krijojë vizualizime të të dhënave në formate nga më të ndryshmet grafike (lloje të ndryshme chart si pie chart, column chart, line chart, KPI, area chart), tabelare ose matricore, sipas përzgjedhjeve të vetë përdoruesit.
10. Mundeson publikimin e raporteve të krijuara, për përdoruesit e tjerë dhe të disponueshme si për platforma web dhe mobile. Mundësia e publikimit dhe e konsultimit të raporteve të publikuara duhet të jepet për të paktën 5 përdorues të postës.
11. Kërkohet që të paktën raportet e mëposhtme të jenë të ndërtuara paraprakisht dhe të gatshme për përdorim nga përdoruesit:

11.1 Për sistemet Eterna Financiare dhe Eterna Postare duhet numri i veprimeve të kryera në nivel Filiali, Zyre dhe shërbimi, të krahasura sipas periudhës 3 mujore dhe mes 2 viteve të fundit.

11.2 Për sistemet Eterna Financiare duhet numri i veprimeve të kryera dhe totali i arkëtimeve në lekë në nivel filiali dhe zyrë për një periudhë një mujore ose një vjecare.Për sistemin Eterna Postare duhet numri i pranimeve dhe i dorëzimeve në volum, sipas periudhave 3 mujore, të krahasuara me vitin paraardhës.

11.3 Për sistemin Eterna Postare duhet numri dhe sasia në lekë e objekteve postare të pranuara, sipas klasave, karakteristikave, mënyrave të pranimit të objektit postar, e krahasur në përiudhë 3 mujore, sipas 2 viteve të fundit.

11.4 Duhet një raport mbi përdoruesit në sistemin Eterna Financiare dhe Eterna Postare në nivel Filiali Zyre dhe profilet që kanë këto përdorues.

11.5 Nevojiten raporte statistikore për numrin e veprimeve dhe totalin e arkëtimeve në lekë, të kategorizuara sipas shërbimeve, dhe të krahasuara sipas periudhave 3 mujore midis 2 viteve të fundit.

12. Në sistemin Eterna Financiare dhe Eterna Postare, cdo aktivitet i gjeneruar nga përdoruesit ndërmjet këtij sistemi duhet të log-ohet ( regjistrohet) me qëllim përpunimin dhe analizimin e mëtejshëm të tij.
13. Mesazhet e regjistruara në log, nisur nga mënyra e gjenerimit të mesazhit duhet të kategorizohen në nivelet Debug,Info, Warn, Error dhe Fatal.
14. Niveli Fatal do të konsiderohen të gjitha gabimet të cilat bllokojnë totalisht përdorimin e sistemit dhe duan me patjetër ndërhyrje njerëzore për të kthyer situatën në gjendje normale.
15. Niveli Error do të konsiderohen të gjitha gabimet që nuk arrihet të përpunohen nga sistemi, pra nuk janë parashikuar të kapen prej tij dhe kapen në shtresën e fundit të procesimit, të tipit pamundësi për tu lidhur me databazat operacionale, pamundësi për të

aksesuar shërbimet e palëve të treta, apo e pamundur të përpunohet përgjigjja e deserializuar e webservice të këtyre palëve.

16. Niveli Warn do të konsiderohen të gjitha gabimet që mund të përpunohen nga sistemi, por që tregojnë një situatë të pazakontë që ka nevojë për vëmendje te mëtejshme. Një situatë tipike do të ishte një webservice i palës së tretë që kthen përgjigje por nga përgjigjja kuptohet që ky service nuk është në gjëndje pune.
17. Nivelet Info do të konsiderohen të gjitha mesazhet e tjera të sistemit, që ndodhin gjatë rrjedhës normale të tij. Përshembull cdo pagesë e regjistruar në sistemin Eterna Financiare, e realizuar me suskses në sistem, duhet të regjitrohet në log sipas këtij niveli.
18. Niveli Debug është nivel i detajuar i informacionit i cili përdoret vetëm në situatë të investigimit të skenarëve apo proceseve. Ky nivel do të përfshijë log deri te veprimet ndihmëse si mbushje e listave përzgjedhëse apo hapje fillestare e formave pa kryer veprime të mëtejshme etj etj.
19. Informacioni që do të log-ohet është i ndryshëm në varësi të veprimit që po bëhet në sistemin Eterna por miminalisht do të përmbajë: të dhënat identiifikuese të përdoruesit që ka bërë veprimin, degën postare, datën dhe orën e saktë të veprimit, ip e kompjuterit nga është bërë veprimi, si dhe një mesazh që përshkruan në mënyrë sa më të plotë tipin e veprimit. Në rastin e nivelit Warn, Error dhe Fatal do të përmbahet edhe detaji i gabimit duke përfshirë metodën ku ndodhi,rreshti specific i kodit burim dhe gjithë rrjedhën e metodave thërritëse në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm si informacion për identifikimin sa më të shpejtë të problemit.
20. Në cdo veprim të bërë në sistemin Eterna Financiare, në rastin e pagesave për palët e treta duhet të regjistrohet i gjithë informacioni ndihmës për shërbimin. Përshembull në rastin e një pagese të bërë tek OSHEE, duhet të ruhet numri unik i transaksionit të regjistruar në databazën operacionale, Emrin e abonentit, numri i faturës dhe i kontratës së OSHEE, muaji dhe viti i faturës së paguar.
21. Loget që gjenerohen në Sistemin Eterna dhe Financiare duhet të jenë të kategorizuar dhe për nga burimi i gjenerimit të log-ut. Duhet të kemi të paktën 2 burime për sistemin Eterna Postar dhe Eterna Financiare si dhe brenda tyre duhet të ketë një kategorizim të mëtejshëm si Security Log, Application Log dhe WebService Log.
22. Security Log duhet të regjistrohet cdo gjë që ka të bëjë me sigurinë e sistemit, si tentativë të suskseshme apo jo për tu loguar në sistem, ndryshim password apo të dhënash të tjera tek përdoruesi i sistemit, dhënie apo heqje aksesi tek modulet apo profilet e sistemit.
23. Application Log do të regjistrohet cdo gjë tjetër që ka të bëjë me sistemin Eterna Financiare dhe Postare por që nuk ka lidhje direkte me shërbimet e palëve të treta.
24. WebService Log do të regjistrohet cdo gjë që ka të bëjë me komunikimet direkte me service-et e palëve të treta si shërbimet e OSHEE, Gjobave, Ujësjellësit në rastin e financiarit apo Shërbimi i Import/Export të IPS në rastin e postarit.
25. Të indeksohet në Elastic Search të gjitha loget e sistemit Eterna Financiare dhe Postare dhe të mundësohet që ndërmjet informacionit të ruajtur në këto log-e:

25.1 Të ketë mundësi për të monitoruar performancën e shërbimeve me palët e treta si me OSHEE, Gjobat, Ujësjellësit dhe shërbime të tjera që ofrohen me webapi.

25.2 Të jepen statistika me bazë ditore ose mujore në lidhje me numrin e gabimeve që ndodhin me shërbimet e mësipërme.

25.3 Të mundësohet që të kërkohet në log-et e indeksuara në Elastic Search me emrin e personit që ka bërë arkëtimin duke shmangur kërkime me përafërsi në databazat operacionale, që kanë kosto të lartë në nivel resource -esh për serverat. Një rast konkret psh është që të kërkohet me emër ose mbiemër kontrate në ElasticSearch për pagesat e OSHEE të bëra nga një individ pranë sporteleve të postës

25.4 Të përdoret për track apo dhe për evente të tjera të sistemit Eterna Postare sic mund të jenë dorëzimet e objektit për një individ të caktuar.

25.5 Të japë informacion mbi ngarkesën e sistemeve Eterna Financiare dhe Postare duke u bazuar në numrin e veprimeve në këto sisteme të regjistruara në log-et.

25.6 Të mundësohet krijimi i një dashboard-i tek sistemi Eterna, që ju jep mundësinë përdoruesve të krahasojnë volumin e veprimeve të bëra nga ana e tyre , me punonjësit e tjerë të degës, filialit apo në nivel republike.

26. Indeksimi i logeve në ElasticSearch duhet të jetë një procedurë, dështimi i të cilës nuk sjell bllokim të punës të sistemit dhe gjithashtu nuk sjell humbje të të dhënave log.
27. Instancat ElasticSearch duhet të jenë në servera të ndryshëm nga ai i aplikimit që mos sjellin ngarkesë në sistem.
28. Informacioni i loge-ve duhet të kalojë bruto nga burimi(server i aplikimit) dhe të përpunohet para se të indeksohet në ElasticSearch duke mundësuar:

28.1 Cdo fushë e log-ut(sipas pikës 19) të jetë fushë edhe në ElasticSearch

28.2 Koha kur ka ndodhur ngjarja të jetë fushë e diferencuar nga koha kur u indeksua në ElasticSearch

28.3 Cdo burim/kategori logu të jetë indeks i vecuar në ElasticSearch

29. Të gjitha përpunimet e mësipërme të kryhen në një server të ndryshëm nga serveri i aplikimit në mënyrë që mos të ndikojnë në ngarkesën totale të sistemit.

**Ndryshimet e realizuar në sistemin Core Eterna në mënyrë që të gjenerohen log-et e nga të gjithë modulet ekzistuese të këtij sistemi**

- Jane realizuar ndryshimet e duhura në sistemin Eterna, pothuajse në cdo modul dhe cdo funksion të tij që të realizojë gjenerimin e nevojshëm të log-eve që më vonë të bëhet e mundur leximi i tyre dhe indeksimi në Elastic Search.
- Modifikime në sistem duhen bërë për të gjithë funksionet që duhet të gjenerojnë logs nga sistemi Eterna.
- Siguria është një tipar tjetër që do të konsiderohet seriozisht gjatë zhvillimit të këtyre ndryshimeve për të siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë.
- Gjithashtu sistemi Eterna duhet të modifikohet në mënyrë që tju japë përdoruesve të tij një dashbord me informacionin të veprimeve të tyre.

Ndyshimet që jane implementuar janë si mëposhtë:

1. Në sistemin Eterna Financiare dhe Eterna Postare, cdo aktivitet i gjeneruar nga përdoruesit ndërmjet këtij sistemit duhet të log-ohet ( regjistrohet) me qëllim përpunimin dhe analizimin e mëtejshëm të tij.
2. Mesazhet e regjistruara në log, nisur nga mënyra e gjenerimit të mesazhit duhet të kategorizohen në nivelet Debug,Info, Warn, Error dhe Fatal.

3. Niveli Fatal do të konsiderohen të gjitha gabimet të cilat bllokojnë totalisht përdorimin e sistemit dhe duan me patjetër ndërhyrje njerëzore për të kthyer situatën në gjendje normale.
4. Niveli Error do të konsiderohen të gjitha gabimet që nuk arrihet të përpunohen nga sistemi, pra nuk janë parashikuar të kapen prej tij dhe kapen në shtresën e fundit të procesimit, të tipit pamundësi për tu lidhur me databazat operacionale, pamundësi për të aksesuar shërbimet e palëve të treta, apo e pamundur të përpunohet përgjigjja e deserializuar e webservice-eve të këtyre palëve.
5. Niveli Warn do të konsiderohen të gjitha gabimet që mund të përpunohen nga sistemi, por që tregojnë një situatë të pazakontë që ka nevojë për vëmendje të mëtejshme. Një situatë tipike do të ishte një webservice i palës së tretë që kthen përgjigje por nga përgjigjja kuptohet që ky service nuk është në gjendje pune.
6. Nivelet Info do të konsiderohen të gjitha mesazhet e tjera të sistemit, që ndodhin gjatë rrjedhës normale të tij. Përshembull cdo pagesë e regjistruar në sistemin Eterna Financiare, e realizuar me suskses në sistem, duhet të regjistrohet në log sipas këtij niveli.
7. Niveli Debug është nivel i detajuar i informacionit i cili përdoret vetëm në situatë të investigimit të skenarëve apo proceseve. Ky nivel do të përfshijë log deri te veprimet ndihmëse si mbushje e listave përzgjedhëse apo hapje fillestare e formave pa kryer veprime të mëtejshme etj etj.
8. Informacioni që do të log-ohet është i ndryshëm në varësi të veprimit që po bëhet në sistemin Eterna por miminalisht do të përmbajë: të dhënat identifikuese të përdoruesit që ka bërë veprimin, degën postare, datën dhe orën e saktë të veprimit, ip e kompjuterit nga është bërë veprimi, si dhe një mesazh që përshkruan në mënyrë sa më të plotë tipin e veprimit. Në rastin e nivelit Warn, Error dhe Fatal do të përmbahet edhe detaji i gabimit duke përfshirë metodën ku ndodhi,rreshti specifik i kodit burim dhe gjithë rrjedhën e metodave thërritëse në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm si informacion për identifikimin sa më të shpejtë të problemit.
9. Në cdo veprim të bërë në sistemin Eterna Financiare, në rastin e pagesave për palët e treta duhet të regjistrohet i gjithë informacioni ndihmës për shërbimin. Përshembull në rastin e një pagese të bërë tek OSHEE, duhet të ruhet numri unik i transaksionit të regjistruar në databazën operacionale, Emri i abonentit, numër i faturës dhe i kontratës së OSHEE, muaji dhe viti i faturës së paguar.
10. Loget që gjenerohen në Sistemin Eterna Postare dhe Financiare duhet të jenë të kategorizuara dhe për nga burimi i gjenerimit të log-ut. Duhet të kemi të paktën 2 burime për sistemin Eterna Postare dhe Eterna Financiare si dhe brenda tyre duhet të ketë një kategorizim të mëtejshëm si Security Log, Application Log dhe WebService Log.
11. Security Log duhet të regjistrohet cdo gjë që ka të bëjë me sigurinë e sistemit, si tentativë të suksseshme apo jo për tu loguar në sistem, ndryshim password apo të dhënash të tjera tek përdoruesi i sistemit, dhënie apo heqje aksesi tek modulet apo profilet e sistemit.
12. Application Log do të regjistrohet cdo gjë tjetër që ka të bëjë me sistemin Eterna Financiare dhe Postare por që nuk ka lidhje direkte me shërbimet e palëve të treta.
13. WebService Log do të regjistrohet cdo gjë që ka të bëjë me komunikimet direkte me service-et e palëve të treta si shërbimet e OSHEE, Gjobave, Ujësjellësit në rastin e financiarit apo Shërbimi i Import/Export të IPS në rastin e postarit.

14. Të indeksohet në Elastic Search të gjitha loget e sistemit Eterna Financiare dhe Postare dhe të mundësohet që ndërmjet informacionit të ruajtur në këto log-e:

14.1 Të ketë mundësi për të monitoruar performancën e shërbimeve me palët e treta si me OSHEE, Gjobat, Ujësjellësit dhe shërbime të tjera që ofrohen me webapi.

14.2 Të jepen statistika me bazë ditore ose mujore në lidhje me numrin e gabimeve që ndodhin me shërbimet e mësipërme.

14.3 Të mundësohet që të kërkohet në log-et e indeksuara në Elastic Search me emrin e personit që ka bërë arkëtimin duke shmangur kërkime me përafërsi në databazat operacionale, që kanë kosto të lartë në nivel resource -esh për serverat. Një rast konkret psh është që të kërkohet me emër ose mbiemër kontrate në ElasticSearch për pagesat e OSHEE të bëra nga një individ pranë sporteleve të postës

14.4 Të përdoret për track apo dhe për evente të tjera të sistemit Eterna Postare sic mund të jenë dorëzimet e objektit për një individ të caktuar.

14.5 Të japë informacion mbi ngarkesën e sistemeve Eterna Financiare dhe Postare duke u bazuar në numrin e veprimeve në këto sisteme të regjistruara në log-et.

14.6 Të mundësohet krijimi i një dashboard-i tek sistemi Eterna, që ju jep mundësinë përdoruesve të krahasojnë volumin e veprimeve të bëra nga ana e tyre , me punonjësit e tjerë të degës, filialit apo në nivel republike.

15. Indeksimi i logeve në ElasticSearch duhet të jetë një procedurë, dështimi i të cilës nuk sjell bllokim të punës të sistemit dhe gjithashtu nuk sjell humbje të të dhënave log.
16. Instancat ElasticSearch duhet të jenë në servera të ndryshëm nga ai i aplikimit që mos sjellin ngarkesë në sistem.
17. Informacioni i loge-ve duhet të kalojë bruto nga burimi(server i aplikimit) dhe të përpunohet para se të indeksohet në ElasticSearch duke mundësuar:

17.1 Cdo fushë e log-ut(sipas pikës 19) të jetë fushë edhe në ElasticSearch

17.2 Koha kur ka ndodhur ngjarja të jetë fushë e diferencuar nga koha kur u indeksua në ElasticSearch

17.3 Cdo burim/kategori logu të jetë indeks i vecuar në ElasticSearch

18. Të gjitha përpunimet e mësipërme të kryhen në një server të ndryshëm nga server i aplikimit në mënyrë që mos ndikojnë në ngarkesën totale të sistemit.

**Ndërtimi i Data Warehouse dhe Business Inteligence**

Jane realizuar punët e mëposhtme:

1. Ndërtimi i një sistemi Data Warehouse që duhet të bazohet mbi një platformë që të jetë në gjendje të ngarkojë, transformojë dhe integrojë të dhënat e databazave operacionale të postës, të sistemit Eterna.
2. Të gjitha transformimet dhe integrimet duhet të bëhen në mënyrë automatike, pa ndërhyrje njerëzore.
3. Ndërtimi i një database Data Warehouse që të mundësojë organizimin e të dhënave nga databazat operacionale, në mënyrë të konsoliduar dhe të standartizuar, duke e bërë të mundur vendimmarrjen e postës ndërmjet mjeteve analitike dhe raportuese.
4. Modeli i databazës duhet të bazohet mbi skema dimensionale dhe faktike, duke marrë informacionin e vlefshëm nga databazat operacionale për të gjitha shërbimet financiare dhe postare të sistemit ETERNA.

4.1 Për shërbimin e OSHEE, duhet të kalohet në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksionive të OSHEE ( arkëtim, kamat vonesat, komision), koha e ekzekutimit të veprimit (ditë, muaj, vit), dhe në fakte vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.2 Për shërbimin e Ujësjellësit duhet të kalohet në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksionive të ujësjellësit ( arkëtim, kamat vonesat, komision), kodet e institucioneve të bashkive për të cilat bëhen pagesat, koha e ekzekutimit të veprimit ( ditë, muaj , vit), dhe në fakte vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.3 Për shërbimin e gjobave duhet të kalohet në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksionive të gjobave (arkëtim, kamat vonesat, komision), kodet e institucioneve, koha e ekzekutimit të veprimit ( ditë, muaj , vit), dhe në fakte vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.4 Për shërbimin e doganave duhet të kalohet në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksioneve të doganave (TVSH, komisionet, Tarifë Doganore si dhe tipe të tjera transaksionesh të lidhura me këtë shërbim), biznes ose individ për të cilin është bërë veprimi doganor, koha e ekzekutimit të veprimit (ditë, muaj , vit), dhe në faktet vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.5 Për shërbimin e taksave të bashkisë, duhet të kalohet në dimensione informacioni i zyrave postare, filialet, degët, përdorues, llogaritë, tipet e transaksioneve të taksave të bashkisë (komisione, taksë për zënien e hapësirës publike, taksë pastrimi si dhe të gjitha transaksionet për llojet e taksave që mbulohen nga ky shërbim), kodi vendor, koha e ekzekutimit të veprimit (ditë, muaj, vit), dhe në fakte vlera e transaksioneve, numri i veprimeve.

4.6 Për shërbimet postare duhet të kalohen në dimensione karakteristikatat e objektit postar, tipi i transportit, mënyrat e pranimit, institucionet, shërbime të veçanta dhe në fakte numri i objekteve si dhe tarifat e arkëtuara.

4.7 Për shërbime postare duhet të kalohen në dimensione të gjitha ngjarjet e objekteve postare, si dhe koha e ekzekutimit të tyre, dhe në fakte numri i veprimeve.

4.8 Për shërbimet postare duhet të futen në dimensione tipet e thasëve, ngjarjet e thasëve, transportet e thasëve dhe ngjarjet e lidhur me transaportin e thasëve.

5. Ofrimi i një tools-i (tools për business inteligence desktop) për të gjithë përdoruesit e biznesit që mundëson krjimin e raporteve dinamike nga vetë përdoruesit e sistemit.
6. Tools-i duhet të mundësojë lidhjen me databazën Data Warehouse, dhe të mundësojë që marrja e informacionit të bëhet në mënyrë direkte duke pyetur databazën ose të ngarkohet në mënyrë offline që raporti të përdoret në mënyrë të pavarur edhe pa lidhje direkte me databazën.
7. Të mundësojë përdoruesin e biznesit që të përgatisë dhe të modelojë informacionin në mënyrë të pavarur duke i lejuar atij përthithjen, transformimin e mëtejshëm , integrimin dhe pasurimin e informacionit të Data Warehouse.
8. Ti mundësojë përdoruesve të biznesit që të gjejnë faktorët në ndryshimet në periudha të ndryshme kohore, ndërmjet funksionaliteteve si grupime, parashikime dhe clusterizime.
9. Ndërmjet përdorimit të templateve të gatshme të të mundësojë përdoruesin që të krijojë vizualizime të të dhënave në formate nga më të ndryshmet grafike (lloje të ndryshme chart si pie chart, column chart, line chart, KPI, area chart), tabelare ose matricore, sipas përzgjedhjeve të vetë përdoruesit.

10. Të mundësojë publikimin e raporteve të krijuara, për përdoruesit e tjerë dhe të disponueshme si për platforma web dhe mobile. Mundësia e publikimit dhe e konsultimit të raporteve të publikuara duhet të jepet për të paktën 5 përdorues të postës.
11. Kërkohet që të paktën raportet e mëposhtme të jenë të ndërtuara paraprakisht dhe të gatshme për përdorim nga përdoruesit:

11.1 Për sistemet Eterna Financiare dhe Eterna Postare duhet numri i veprimeve të kryera në nivel Filiali, Zyre dhe shërbimi, të krahasura sipas periudhe 3 mujore dhe mes 2 viteve të fundit.

11.2 Për sistemet Eterna Financiare duhet numri i veprimeve të kryera dhe totali i arkëtimeve në lekë në nivel filiali dhe zyre për një periudhë një mujore ose një vjecare.

11.3 Për sistemin Eterna Postare duhet numri i pranimeve dhe i dorëzimeve në volum, sipas periudhave 3 mujore, të krahasuara me vitin paraardhës.

11.4 Për sistemin Eterna Postare duhet numri dhe sasia në lekë e objekteve postare të pranuara, sipas klasave, karakteristikave, mënyrave të pranimit të objektit postar, e krahasur në periudhë 3 mujore, sipas 2 viteve të fundit.

11.5 Duhet një raport mbi përdoruesit në sistemin Eterna Financiare dhe Eterna Postare në nivel Filiali Zyre dhe profilet që kanë këto përdorues.

11.6 Nevojiten raporte statistikore për numrin e veprimeve dhe totalin e arkëtimeve në lekë, të kategorizuara sipas shërbimeve, dhe të krahasuara sipas periudhave 3 mujore midis 2 viteve të fundit.

**Licensat per tools- Business Inteligence (Power BI)**

Kompania fituese duhet te mbuloje kostot per licensimin e toolsit Power BI Pro per 5 perdorues te Postes.

**<u>Periudha e kohës për të cilën ofrohet suporti</u>**

o Mbështjetja operacionale do të përcaktohet nga e Hëna në të Premte, në fashën kohore nga ora 08:00 deri në ora 20:00.

**1. <u>Specifikimet teknike për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit</u>**

Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen janë si më poshte:

1. Korigjimin e të gjithë gabimeve (bug-eve) të funksioneve të moduleve perkatese, pas raportimit të marrë nga Personi i kontaktit të postës.

2. Monitorimi periodik i performancës së sistemit. Në raste kur vërehen probleme në preformance, Operatori Ekonomik duhet të ndërhyje për zgjidhjen e tyre duke optimizuar kodin burim.

3. Kompania duhet të garantojë suportin perkatese në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm afekton sistemin.

4. Koha e përgjigjes dhe e zgjidhjes së kerkesave të mësiperme duhet të bëhet në bazë të tabelës së pikës që jepet në paragrafin “Pergjigja dhe shkallezimi i shërbimit”

**Përgjigja dhe shkallëzimi i shërbimit**

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve/kërkesave dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre.

| Kategoria A ( Kritik/ I Larte) | Kategoria B (I Mesem) | Kategoria C (I Ulet) |
|---|---|---|
| Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal | Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal | Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimale aktivitetin |
| *Numri i përdoruesve të ndikuar* | | |
| **Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër** *shumë të madh* **të përdoruesve** | **Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër** *të vogël* **të përdoruesve** | **Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues** |
| *Pezullimi i punës* | | |
| **Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit** *të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.* | **Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit** *të realizojnë pjesë te punës së tyre* | **Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit** *të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre*, |
| *Zgjidhje alternative e përkohshme* | | |
| *Nuk ka një mënyre alternative* **të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit** | *Ka pjesërisht një mënyre alternative* **të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.** | *Ka një mënyrë alternative* **të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.** |
| *Koha e përgjigjes* | | |
| *- 60 min. për të kthyer përgjigje*<br>*- Në vend brenda 4 ore.* | *-6 ore per të kthyer përgjigje*<br>*-Në vend brenda 2 diteve* | *-2 dite.për të kthyer përgjigje*<br>*-Në vend brenda 4 diteve* |
| *Koha e zgjidhjes* | | |
| **Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 1 dite pas kërkesës.** | **Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.** | **Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 5 ditë kalendarike.** |

***Të dhënat e mësipërme janë opsionale dhe të zbatueshme nëse do ketë raste të tilla.***

**A. Shërbime të konsulencës**

1. Asistencë për stafin teknik të institucioneve në analizën e të dhënave, procedurat e backup-it, dhe raportimin e performacës.

2. Asistencë teknike për problemet e lidhura me komunikimin me sisteme apo komponentë të infrastrukturës.

**B. Përmirësime të sistemit**

3. Azhornime të sistemit në aspektin e sigurisë në rastet kur rregullore të reja hyjnë në fuqi.

4. Për komponentët e sistemit të cilët kanë qenë pa mirëmbajtje deri tani, kërkohet që të verifikohet funksionimi i tyre, zgjidhja e problematikave nëse ekzistojnë si dhe kthimi i tyre në gjendje normale pune.

Për çdo modul të përmendur më lart, çdo zhvillim që është kryer deri në momentin që hartohen këto specifikime, është përmendur apo jo në mënyrë specifike, do të konsiderohet një zhvillim i kryer.

**Shtojca 6**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet:

Mirembajtja e Sistemit Eterna dhe komponentëve të saj do te kryhet prane Sistemit Eterna, te Drejtorise se Pergjithshme te Posta Shqiptare sh.a. per nje periudhe 24 muaj nepermjet nje kontrolli dhe mirembajtjeje periodike per cdo jave te pare te muajit te vitit ushtrimor.

Mirembajtja e Sistemit Eterna dhe komponentëve të saj do te dokumentohet permes nje procesverbali te mbajtur mes paleve dhe firmosur prej tyre.

**Afatet e ekzekutimit: Sipas grafikut ne Termat e References**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |

**Shtojca 7**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve**: Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në zyrat postare në të cilat janë instaluar këto sisteme.

**Detyrat:** Ky shërbim duhet të mirëmbajë të gjitha funksionalitet ekzistuese të versioneve të moduleve kryesore të sistemit Eterna dhe funksionalitet kryesore te Eterna Financiare, Eterna Postare, Eterna Gateway dhe Eterna Finance-Kontabilitet, Burime Njerezore, Posta Retail Outlet dhe Buzines Hub .

**Shpërndarja:** Ne te gjitha zyrat postare ku jane instaluar keto sisteme si dhe ne Drejtorine e Pergjithshme te Posta Shqiptare sh.a.
**Vendi i kryerjes së shërbimeve**: Prane Sistemit Eterna, te Drejtorise se Pergjithshme te Posta Shqiptare sh.a

**Shtojca 8**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

